

## KREJT SHOKËT E MI (pjesa 1)

### Synimi Më I Madh Prej Krejtve – DASHURIA

Në dy urdhëresa përmbledhet e gjithë Bibla:

- Duaj Perëndinë.
- Duaj njeriun, të afërmin tënd si veten.

Si t'i duam të tjerët dhe si të japim dashuri kur të gjithë duan të marrin? Ka shumë këngë që flasin për dashurinë ndaj të tjerëve si mik, shok, vëlla, motër. Kemi shumë fjalë të urta dhe këngë. Ja disa tituj këngësh:

- *Krejt shokët e mi.*
- *Me 30 vet.*
- *Eja, o shoku ynë, të kemi pritur.*
- *Lean on Me, when you're not strong.*
- *I'll Be There for You.*
- *Count on Me, like 1, 2, 3, I will Be There.*
- *I See Your True Colors, that's why I Love You.*

Bibla thotë: Kërkoni dashurinë. Synimi më i madh është dashuria; koha më e mirë për të dashuruar është tani.

**1 Korintasve 14:1** *"Kërkoni Dashurinë..."* Një përkthim tjetër: *"Dashuria të jetë synimi i parë."*

Pse kjo, ndër të gjitha gjërat që mund të kishte thënë Perëndia, *"Ndërtoje jetën mbi këtë gjë apo atë tjetrën"*, përse ka zgjedhur dashurinë?

Do të shikojmë për disa javë vargje nga 1 Korintasve 13. Aty thuhet që të kemi dashurinë si synimin tonë më të madh në jetë, sepse është më kryesorja. Ky kapitull nuk është vetëm për dasma; është shkruar për jetën e përditshme. Ja përse është më e rëndësishme dashuria:

#### Pa dashuri...

##### 1. Çdo Gjë Që Them Është Teneqe!

**1 e Korintasve 13:1** *"Po të flisja gjuhët e njerëzve dhe të engjëjve dhe të mos kisha dashuri, do të bëhesha si një bronx që kumbon ose si cimbali që tingëllon."*

Fjalët pa dashuri janë boshe, janë zhurmë. Korintasit ishin shumë të dhënë pas oratorisë. Krenoheshin për rrjedhshmërinë në të folur në bisedat e tyre. Ata thonin, "Ne mund të flasim në gjuhët e njerëzve dhe të engjëjve." Perëndia u përgjigjet atyre, "E po pastaj, se jeni oratorë ju, çfarë pastaj?..." Nëse nuk ka dashuri, është e kotë.

#### Pa dashuri...

##### 2. Ajo Që Di Nuk Mjafton

**1 e Korintasve 13:2a** *"Edhe sikur të kisha dhuntinë e profecisë, edhe të dija të gjitha misteret dhe mbarë shkencën...po të mos kisha dashuri, nuk jam asgjë."*

Ti mund të jesh njëshi i klasës, apo më i shkathti në shtëpi, madje mund të kesh edhe tituj të lartë si Dr. Prof.. Ti mund të jesh aq i ditur sa që nuk ka pyetje që të mos i përgjigjesh, nuk ka gjë të re që ti të mos e kesh marrë vesh, e njeh Biblën në majë të gishtave, por Perëndia thotë, "Pa dashuri nuk është asgjë." Pse? Sepse: **1 e Korintasve 8:1b** *"Njohuria krekos, por dashuria ndërton..."*

Fakt është se gjërat që dimë ne sot, pas 10 vjetësh, rreth 3% të tyre do të jenë të vlefshme, ndërsa pjesa tjetër, 97%, do të ketë dalë jashtë mode. Bota po shpërthen nga informacioni dhe nga njohuritë. Nuk mund të jesh në kontakt me çdo gjë, sepse çdo gjë po zhvillohet shumë shpejt.

Por përsëri, me gjithë këto dije, a është zgjidhur ndonjë nga problemet e njerëzve? Jo. Bota nuk ka nevojë për më shumë dije; bota ka nevojë për më shumë dashuri. Pa dashuri, çdo gjë që themi është e mangët.

**Pa dashuri...**

### **3. Besimi Është "i Thatë"**

**1 e Korintasve 13:2b** *"... dhe të kisha gjithë besimin sa të luaja nga vendi malet, por të mos kisha dashuri, nuk jam asgjë."*

Nuk ka rëndësi se çfarë beson, nëse nuk ke dashuri.

Që do të thotë, që të jesh i krishterë nuk të mjafton vetëm të besosh disa gjëra, disa të vërteta të Biblës, disa doktrina, disa besime mbi disa tema, dhe kaq është.

Dikush tha: "Po unë jam i krishterë sepse i besoj Jezusit." Edhe djalli beson që Jezusi është Biri i Perëndisë. Pyetja nuk është nëse e beson, por "A e do ti Jezusin? A e kupton ti që Ai të do ty? A i do njerëzit e tjerë në emër të Jezusit?" Krishterimi është një mënyrë jetese, dhe është një mënyrë jetese me bazë dashurinë, jo thjesht informacion.

**Galatasve 5:6b** *"... ajo që vlen është, besimi që vepron me anë të dashurisë."*

Ky varg na kujton se ajo që ka rëndësi është besimi i treguar me dashuri, por pa dashuri është i kotë.

**Pa dashuri...**

### **4. Cdo dhënie është pa shumë vlerë**

**1 e Korintasve 13:3** *"Edhe sikur të ndaja (jepja) gjithë pasuritë e mia për të ushqyer të varfërit...e të mos kisha dashuri, nuk do të më vlente asgjë!"*

Ky varg thotë se mund të japësh çdo gjë që ke, jo vetëm të dhjetën, mund të japësh çdo gjë që ke dhe përsëri mund ta bësh pa dashuri. Si ka mundësi? Sepse mund të japësh për arsye të gabuara.

Ka njerëz që japin për të dukur mirë. Njëri tha: "Dua të jap të dhjetën, por me një kusht: dua që ta shohin të gjithë sa shumë lekë jap për kishën."

Disa japin që të kenë autoritet, për të kontrolluar njerëzit. Shpesh të rriturit u japin fëmijëve në mënyrë që t'i kontrollojnë, duke thënë: *"Të jap këtë, nëse bën këtë."*

Dikush mund të japë sepse ndihet në faj, ose duke menduar se Zoti do t'i bëjë mirë.

Fakti që dikush jep nuk do të thotë automatikisht që e bën me dashuri.

*Mund t'i japësh dikujt pa dashuri, por nuk mund të duash dikë dhe të mos i japësh.*

### **Pa dashuri...**

#### **5. Cdo Sakrificë, Zëre Se Nuk Ndodhi Fare**

**1 e Korintasve 13:3b** *"...edhe sikur ta jepja trupin tim që të digjej, e të mos kisha dashuri, nuk do të më vlente asgjë."*

Dikush mund të bëjë një listë të madhe me arritjet që ka patur në jetë, mund të ketë qenë i pari në shumë gjëra, madje mund të ketë sakrifikuar jetën për gjëra të mëdha—Mbretërinë e Perëndisë—por nëse nuk i ka bërë me dashuri, është e kotë. Ka harxhuar jetën kot.

Shiko: Perëndia mund ta përdorë një njeri që është orator, një njeri të ditur, një gjeni, besimin e dikujt që bën mrekulli, bujarinë e dikujt, dedikimin e një martiri, por nëse veprat bëhen pa dashuri, nuk vlejné fare.

Pali dëshiron që të gjithë ta kuptojnë dhe e thekson në pesë mënyra të ndryshme për të siguruar që të gjithë e kapin: "Po të flisja," "Po të kisha," "Sikur të ndaja," "Po të dija," "Sikur të jepja." Por të gjitha janë të kota pa dashuri!

Le të jetë ky synimi yt më i madh në jetë: **të dua të tjerët**. Nuk ka gjë më të rëndësishme në jetë.

**Jeta minus dashurinë është baraz me zero.**

Ai e thotë këtë herë pas here. Jeta pa dashuri është zero.

### **Por, Si ta Praktikoj Dashurinë?**

Pasi e ka thënë mirë e mirë këtë gjë në lidhje me prioritetin e dashurisë në jetë, ai fillon të flasë se si ta vësh në praktikë dashurinë.

**Kolosianëve 3:14** *"Përmbi të gjitha këto gjëra, vishni dashurinë..."*

Por si mund të bëhet një gjë e tillë?

Le ta përkufizojmë dashurinë. Çfarë do të thotë fjala "dashuri"? Ka mijëra histori dashurie nëpër romane, këngë, filma. Ne themi: *"Unë e dua familjen time, i dua prindërit e mi, e dua gruan time... e dua Perëndinë, e dua vendin tim... e dua qenin tim... dua edhe qershitë... dua fiqtë, e dua shumë plazhin."*

Themi që është gjëja më e rëndësishme në jetë, por si mund ta përkufizojmë siç duhet?

**Së pari**, një mënyrë si është përdorur kjo fjalë është: Dashuria është emocion, dashuri është ajo që ti ndjen. Dashuria ndikon emocionet. Dashuria i krijon emocionet, i shkakton ato. Por ajo nuk është vetëm emocion. Nëse do të ishte vetëm emocion i bie që s'e kontrollon dot.

**Së dyti**, një mënyrë si është përdorur kjo fjalë është e barabartë me fjalën 'seks'. Bëjmë dashuri = bëjmë seks. Por nuk është vetëm aq dashuria. Nganjëherë shumë këngë që quhen këngë dashurie, ngjajnë më shumë si këngë epshi, sesa dashurie.

Ne jetojmë në një shoqëri ku shumë njerëz nuk dinë si të duan, si ta shprehin dashurinë. Ne jemi rritur dhe po rritemi me modele të gabuara dashurie, që vijnë nga filmat apo nga mënyra të tjera.

### **Po çfarë është dashuria, si praktikohet ajo?**

Bibla thotë që është shumë e thjeshtë: Është veprim!

*Dashuria është e duruar, dashuria është e sjellshme, Nuk lakmon, nuk mburret. Nuk është e ashpër. Nuk kërkon të sajat. Nuk nxehet kollaj. Nuk i mban shënim gabimet. Dashuria kënaqet me të vërtetën. Dashuria gjithmonë të mbron, i beson të gjitha, i shpreson të gjitha, nuk heq dorë kurrë, Dashuria nuk ligështohet kurrë.”*

Si e ke shprehur dashurinë deri më sot? A ngjan me këtë që thotë Bibla?

Dy gjëra si ta praktikojmë dashurinë nga ana praktike:

**1. Dashuria është ajo që bën.** Nuk është vetëm diçka që ndjen, është ajo që bën. Shiko tek fjalët që thashë më sipër, janë fjalë që tregojnë veprim. Dashuria nuk është vetëm fjalë të bukura. Por është vepruese. Është të bësh. Është demonstrim, jo thjesht fjalë, jo ilustra, as fjalë të zakonshme.

**2. Dashuria është mundësi zgjedhjeje.** Ti vetë e zgjedh se cilin do dhe cilin nuk do. Ekziston miti se dashuria është e pakontrollueshme. “Rashë në dashuri pa e kuptuar”—sikur dashuria të ishte ndonjë pusëtë e hapur, ku rashë sepse nuk e pashë. Sigurisht që e kupton.

Të njëjtët njerëz që thonë “*Rashë në dashuri*”, pas një viti, apo më shpejt, thonë, “*Nuk e dua më atë njeri.*” Ti zgjedh të mos e duash më atë njeri, ashtu siç zgjedhe ta duash në fillim. Është zgjedhje.

Dashuria nuk është vetëm ndjenjë. Nëse dashuria do të ishte vetëm një ndjenjë, nuk do të mund ta detyrosh. Ndjenjat nuk i forcon dot. Dashuria është veprim (*të bësh për atë person*) dhe zgjedhje (*është në dorën tënde të jesh i hapur për të dashur ose jo një person*).

Dashuria është të çohesh në mes të natës dhe të ndihmosh dikë që ka nevojë për ty, megjithëse ti nuk e ndjen për të bërë një gjë të tillë (*sepse ajo që ndjen në atë moment është jastëku i butë*).

Dashuria është të jesh i duruar me prindërit, motrat/vëllezërit, apo me bashkëshortin/bashkëshorten, edhe atëherë kur të ka ardhur në majë të hundës dhe je i acaruar në kulm.

Dashuria është t'i japësh dikujt atë që ka nevojë dhe jo atë që meriton. Është veprim dhe zgjedhje.

Po lexoja historinë e një gruaje që ndihej e rraskapitur. Ajo gati po kalonte në depresion, ishte shumë e zënë gjithë ditën dhe javën. Ajo thoshte: *“Kur po shikoja veten time si kisha përfunduar, vetëm i bërtisja kalamajve dhe i shaja sa herë që s'bënin atë që u thoja. Më dukej vetja kot fare. Fillova të qaja para Zotit.”* Ndërsa po bënte kohën e qetë dhe po lutej, lexoi 1 e Korintasve 13. Ajo tha: *“Këto pesë fjalë më ngelën në mendje: ‘Pa dashuri nuk jam asgjë.’”*

Ajo i shkroi këto pesë fjalë në copa letre dhe i vuri tek dyert, tek frigoriferi, tek rafti i rrobave të kalamajve, tek lavamani, në banjo, kudo nëpër shtëpi, që kudo që të ishte në shtëpi të kujtonte vetes: *“Pa dashuri nuk jam asgjë.”* Ajo tha:

*“Fillova të jetoj jetën me më shumë dashuri ndaj familjes, sepse kuptova që gjëja më e rëndësishme që mund të bëja për këtë familje ishte të doja. Çdo gjë që bëja, e bëja me dashuri. Dhe ishte aq transformuese për mua. Lumturia u kthye në jetën time dhe në familjen time.”*

Ajo thjesht bëri një zgjedhje: ajo do të bëjë çdo gjë me dashuri. Dhe veproi sipas asaj zgjedhjeje që bëri.

Pali tha: Dashurinë ndaj njerëzve duhet ta kesh synimin e parë, objektivin e parë në jetë.

Pse?

Së pari, sepse është shumë e rëndësishme.

Së dyti, për shkak se sjell gëzim në jetën tënde dhe të tjerëve.

Së treti, për shkak se sjell qëndrueshmëri.

### **Qëndrueshmëria e Dashurisë:**

Pali tha, duhet ta kesh të parën në jetë sepse është e vetmja gjë që do të zgjasë.

**1 e Korintasve 13:7-8a** *“I duron të gjitha, i beson të gjitha, i shpreson të gjitha, mban çdo gjë; Dashuria nuk ligështohet (nuk dekurajohet) kurrë.*

**1 e Korintasve 13:13** *“Tani (në jetë), këto tri gjëra mbeten—besimi, shpresa, dashuria. Por më e madhja nga këto është dashuria.”*

Përse? Si ka mundësi që dashuria është më e madhe se besimi dhe shpresa?

Sepse në qiell do të ketë vetëm dashuri. Bibla thotë se kur ti të jesh në qiell, nuk do të kesh më nevojë për besim, sepse çdo gjë do të bëhet e dukshme. Do ta

shikosh Perëndinë me sy, sesi është. Çdo gjë do të bëhet realitet. Besimi është i lidhur me atë që nuk shikohet; është për atë që ende nuk është zbuluar në mënyrë të plotë.

As shpresa nuk do të të duhet në qiell. Çdo gjë do ta kesh aty. Çdo gjë që të duhet, çdo gjë që ke ëndërruar dhe për të cilën ke patur nevojë. Nuk të duhet më shpresa për ta patur diçka.

Por ama qielli do të jetë plot me dashuri. Ti do ta ndiesh dashurinë në mënyrë të plotë, do të ndihesh 100% i dashur. Pse? Sepse Perëndia është dashuri. Në praninë e Tij, do të ndihesh plotësisht i dashur. Dashuria është e vetmja gjë që do të zgjasë në qiell. Është parimi i vetëm që do ta mbash me vete edhe kur të ikësh nga kjo tokë.

### **Jezusi tha:**

**Gjoni 13:34-35** *“Po ju jap një urdhërim të ri: ta doni njëri-tjetrin; sikurse unë ju kam dashur, ashtu edhe ju ta doni njëri-tjetrin.*

*Prej kësaj do t’ju njohin të gjithë që jeni dishepujt e mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin.”*

Ai tha, “Një urdhërim të ri”. Nuk tha një sugjerim të ri, një ide të re. Por urdhërim. Arsyeja pse po e them këtë është:

Nëse ti i ke besuar Jezu Krishtit, për ty, dashuria është stil jete. Nuk është më një opsion, si “nëse do e ndiej, do ta dua”. Nuk të ngelet mundësi zgjedhjeje nëse do t’i duash të tjerët apo jo. Nëse je besimtar, e ke të urdhëruar: ta doni njëri-tjetrin, të duash të gjithë—atë që është për t’u dashur dhe atë që s’të vjen natyrshëm ta duash.

Por si ta duam njëri-tjetrin? Jezusi tha, *“Sikurse unë ju kam dashur juve.”*

Jezusi është modeli ynë.

Ti mund të thuash, “Por, unë nuk mund t’i dua njerëzit siç i donte Jezusi, sepse Ai ishte i përsosur.”

Ke të drejtë. Prandaj ti ke nevojë për Jezu Krishtin në jetën tënde. Që Ai t’i dojë njerëzit nëpërmjet teje.

Ti nuk mund t’i duash të tjerët me fuqinë tënde. Ti nuk mund të jesh si ai personi që lexova më sipër—i duruar gjithmonë, kurrë nuk nxehesh! Ti nuk mund të jetosh gjithmonë në atë mënyrë. Prandaj, të duhet fuqia e Perëndisë në jetën tënde. Vetëm Jezu Krishti mund të jetë i tillë dhe ta jetojë atë lloj dashurie nëpërmjet teje.

Dashuria është gjëja kryesore në jetë.

Jeta minus dashurinë është zero, asgjë, hiç, kot. Harxhim i pavlerë.

Ai tha, *“Nga kjo do t’ju njohin të gjithë që jemi dishepujt e mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin.”* Shenja e një të Krishteri, shenja dalluese, është dashuria. A dëshiron ta kuptosh nëse dikush e ka me sinqeritet besimin e tij, apo është një person fetar që vetëm flet vargje të Biblës?

E di kush është? Nuk është shenja e kryqit, as pëllumbi, as spiranca, as peshku. Shenja e një të Krishteri është dashuria.

Sa njerëz e dinë që ti je i Krishterë sepse të kanë parë duke u sjellë me dashuri, sepse e ke dashurinë si stil jete?

Ne këndojmë për dashurinë, flasim për të, lutemi për të, studiojmë, por a e praktikojmë? Që dashuria të rritet tek ty dhe ta kesh si parim jete, do të thotë që duhet të hedhësh disa hapa konkretë.

Kur të dalësh prej këtej dhe përplasësh me dikë pa dashje në rrugë, ose po vonohet autobuzi, ose po të vonon kamarieri me porosinë, ose ashensori nuk po ulet, ose shkon në shtëpi dhe je vonë, dhe të tjerët kanë ngrënë dhe nuk ka mbetur asgjë për ty, ose merr një SMS jo shumë të mirë, nëse ke vendosur seriozisht ta kesh dashurinë si stil jete, do të të kërkohet të bësh disa ndryshime të mëdha.

Do të të duhet të marrësh iniciativën.

Sepse dashuria vepron, bën.

**Së pari**, fillo të tregosh dashuri në marrëdhëniet që tashmë i ke: familje, punë, shkollë, lagje, me të dashurin/ën, gruan/burrin, fejuarën. Mendo për të gjitha miqësitë që ke tashmë; a ke nevojë të pajtohesh me dikë me të cilin nuk je sjellë me dashuri këto ditë ose javë?

Fillo të rregullosh marrëdhëniet që ke tashmë.

Ky stil jetese, i/e dashur, nuk është trashëgimi; nuk është diçka që vjen natyrshëm për ne. Dashuria nuk ndodh menjëherë. Ajo kërkon kohë. Kërkon përfshirje dhe përkushtim. Por në fund, ia vlen.

Nëse në këtë kishë tregohet gjithnjë e më shumë dashuri pa kushte, e di çfarë do të ndodhë? Kjo kishë do të bëhet si një koshere mjalti, ku do të tërhiqen të gjitha bletët. Njerëzit do të tërhiqen tek Krishti, jo përmes bindjeve logjike, por përmes dashurisë së Perëndisë. Debatet dhe argumentet nuk do të çojnë njerëzit në qiell. Vetëm dashuria e Perëndisë mund t'i tërheqë dhe të ndikojë në jetën e tyre.

Sa më shumë që ne si kishë të tregojmë dashuri, aq më e madhe do të bëhet kjo kishë. Njerëzit nuk janë të interesuar për sa njohuri kemi; ata duan të dinë sa kujdesemi për ta dhe sa i duam. Njerëzit nuk kanë nevojë për fjalë të bukura apo më shumë informacion. Ata kanë nevojë për dashurinë e Jezus Krishtit.

Kjo është lutja ime, që kisha jonë do të njihet kështu:

*“Në atë vend tregohet dashuri pa kushte ndaj të gjithëve njëllor, dhe aty është rradhë e madhe për të hyrë brenda.”*

Nuk do të thuhet se çfarë predikimi apo çfarë muzike ka, por:

*“Në atë kishë i duan të gjithë njerëzit. Të gjithë janë shumë të dashur dhe miqësorë.”*

Ky është lloji i kishës që i sjell kënaqësi Perëndisë. Ne do të njihemi si një kishë e veçantë, e dalluar nga dashuria që tregojmë.

Dhe kjo ka për ta kënaqur Perëndinë gjithashtu, kur ne tregojmë dashuri ndaj njerëzve të tjerë, ndaj **Krejt Shokëve Të Mi**.

Lutem dhe uroj që këtë javë që fillon nesër, së pari, do ta përjetoni më shumë dashurinë e Perëndisë, dhe së dyti, do të jepni dashuri njerëzve që ju rrethojnë, duke e ditur se dashuria është veprim dhe zgjedhje.

Le të lutemi.